

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË “DIGI CENTER & MARKETING” SH.P.K.**

Në Tiranë, sot më datën 07.02.2025, ortakët:

1. **Z. Ilir Beka**, shtetas Shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë, Shqipëri, i datëlindjes 03.03.1988, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me Letërnjoftim ID Nr. 033611919 dhe nr. personal I80303004V;
2. **Edvin Puriqi**, shtetas Shqiptar, lindur në Rubik dhe banues ne Tirane, Shqipëri, i datëlindjes 26.03.1980, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me Letërnjoftim ID Nr. 032769279 dhe nr. personal I00326134W, konform Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, hartojnë këtë Akt Themelimi:

1. Me vullnetin tonë të lirë themelojmë shoqërinë me emërtimin “DIGI CENTER & MARKETING” Sh.p.k. me seli në
2. Themeluesit e kësaj shoqërie janë Z. Ilir Beka dhe Edvin Puriqi.
3. Selia dhe qendra e kësaj shoqërie është në adresën: Rruga "Brigada 8", Pallati nr.19, Hyrja nr.3, Tirane.

Vula e shoqërisë përmban mbishkrimin “DIGI CENTER & MARKETING” Sh.p.k dhe Niptin e shoqërisë.

4. Shoqëria krijohet me mijetet financiare pronë e ortakëve Edvin Puriqi dhe Ilir Beka.
5. Kapitali themeltar i shoqërisë është 300.000 (treqind mijë) lekë. Pjesëmarria e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre vijon si me poshtë:  
Edvin Puriqi është zotërues i 1 (një) Kuote, që i korrespondon 52 % (pesëdhjetë e dy për qind) të Kapitalit të Shoqërisë.

Ilir Beka është zotërues i 1 (një) Kuote, që i korrespondon 48 % (dyzetë e tetë për qind) të Kapitalit të Shoqërisë.

6. Kjo shoqëri ka statusin e personit juridik shqiptar dhe i nënshtronet legjislacionit përkatës shqiptar.
7. Afati i veprimtarisë së saj do të jetë i papërcaktuar. Ky afat mund të zgjatet dhe mund të shkurtohet në rastet kur shoqëria do të shpërbëhet sipas përcaktimeve që pasqyrohen në statut.
8. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është: *“Ofrimi i sherbimeve te publicitetit dhe marketingut te te gjitha formave, perfshire ketu edhe publiciteti e marketingu duke perdonur metoda innovative, te komunikimit ne distance nepermjet emailit, telefonit, rrjeteve sociale apo çdo lloj platforme tjeter ne fushen e teknologjise. Mbledhja, perpunimi, menaxhimi i te dhenave dhe realizimi i sondazheve e studimeve te ndryshme”*
9. Organ vendimarrës më i lartë në shoqëri është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve që thirret në seancë të zakonshme të paktën një herë në vit dhe drejtohet nga administratori i shoqërisë. Asambleja merr vendime të zakonshme dhe të jashtëzakonshme sipas dispozitave ligjore të përcaktuara në statut.
10. Shoqëria administrohet nga administratori. Kompetencat e administratorit përcaktohen në statut. Me themelimin e këtij akti, administrator i shoqërisë per një afat 5 vjecar caktohet **Z. Ilir Beka**, shtetas Shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë, Shqipëri, i datëlindjes 03.03.1988, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me Letërnjoftim ID Nr. 033611919 dhe nr. personal I80303004V

11. Në këtë shoqëri mund të aderojnë ortakë të tjerë të rinj në kushtet që do të përcaktohen në akt marrëveshjen e bërë në rastin e pranimit të tyre.
12. Po ashtu ortakët kanë të drejtën të ndryshojnë apo shtojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë, sipas interesave të veta ekonomike dhe financiare.
13. Shoqëria ka të drejtë të punësojë specialistë të fushës që i përket objektit të veprimtarisë si dhe punonjës të tjerë me kontratë pune sipas përcaktimeve në Kodin e Punës dhe përgjithësisht me legjislacionin shqiptar në fuqi.
14. Do të konsiderohen veprimtari të Shoqërisë vetëm ato veprime juridiko-civile që do të kryhen nga organet e saj konform disponimeve në Statutin e Shoqërisë dhe në mbështetje të legjislacionit në fuqi.
15. Si rregull veprimet ekonomike të Shoqërisë mbyllen më 31 Dhjetor të çdo viti, përjashtim nga ky rregull do të bëhet kur kërkon organi kompetent ligjor.
16. Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakut të vetëm, administratorit dhe personave të tjerë të punësuar në Shoqëri, në rast se nuk zgjidhen me pajtim, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.
17. Fitimi i nxjerrë nga aktiviteti i ligjshëm i kësaj shoqërie tregtare është në favor të ortakëve të shoqërisë.
18. Ndërkohë ortakët mbartin mbi vete rrezikun e humbjes deri në masën 100% të kapitalit themeltar dhe atij rezervë.
19. Për detyrimet që mund t'ju ketë personave të tjerë juridikë apo fizikë, shoqëria përgjigjet me mjetet e veta financiare dhe materiale.
20. Për funksionimin normal të shoqërisë do të hartohet statuti i shoqërisë ku do të parashikohen hollësitë e mirëfunksionimit dhe administrimit të saj.
21. Veprimtaria e saj private ushtrohet brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
22. Kjo shoqëri mund të mbyllë aktivitetin e vet në rastet e parashikuara në legjislacionin shqiptar dhe në statutin e saj.
23. Shoqëria do të marrë personalitet juridik me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Një kopje e aktit të themelimit së bashku me statutin e shoqërisë, depozitohen nga Administratori i saj Ilir Beka dhe ruhen në QKB (Qendrën Kombëtare e Biznesit).

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË  
“DIGI CENTER & MARKETING” SH.P.K**

**Z. Ilir Beka**

Ilir Beka  


**Z. Edvin Puriqi**

Edvin Puriqi  
